



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:113695
Datë: 04.06.2024
Numri i dokumentit: 05780549

C.nr.793/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, në çështjen kontestimore të paditëses V.S.L., nga Gjakova, të cilën me autorizim e përfaqëson Agim Muhaxhiri, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Banka për Biznes, me seli në Prishtinë, rruga “UÇK”, numër 41, të cilën me autorizim e përfaqëson Durim Ahmetaj, me objekt kontesti: kompensim i të ardhurave, duke vendosur lidhur me parashtrësën për tërheqjen e padisë, jashtë seancës, me 04 qershor 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia, e udhëhequr sipas shenjës C.nr.793/21, e datës 15.06.2012, e paraqitur nga paditësja V.S.L., nga Gjakova, kundër të paditurës Banka për Biznes, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensim i të ardhurave.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja V..L nga Gjakova me datë 15.06.2012, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Banka për Biznes, me seli në Prishtinë, me objekt: kompensim i të ardhurave.

I autorizuari i paditëses me datë 15.05.2024, ka paraqitur parashtrësë me të cilën e ka tërhequr padinë e paditëses, ndaj të paditurës Banka për Biznes, me seli në Prishtinë.

Gjykata një ekzemplarë të parashtresës për tërheqje të padisë ia ka dorëzuar të paditurës, e cila të njëjtën e ka pranuar me datë 27.05.2024, sipas konstatimit në fletë kthesën për dorëzim personal të dorëzuar me shërbimin postar të Postës së Kosovës, ndërsa deri në ditën e marrjes së këtij aktvendimi nuk është deklaruar lidhur me të njëjtën.

Gjykata duke u bazuar në parashtresën e dorëzuar për tërheqjen e padisë, e po ashtu meqenëse e paditura në mënyrë të heshtur është pajtuar me tërheqjen e padisë së paditëses, në kuptim të nenit 261 paragrafi 3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (tutje LPK), në të cilin është paraparë se: *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*, vendosi që konstatoj të tërhequr padinë e paditëses.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 450 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ashtu që vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 261 paragrafi 1, e në lidhje me nenin 387 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.793/21, me 04 qershor 2024

G J Y Q T A R

Durim BALAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa,
konform nenit 261 paragrafi 4 të LPK-së.